- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të përpalluara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 622-23-9402-5-1-1/C518

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10 % të vlerës së kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej: 990 ditë, nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar; (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar,
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda: 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është: 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të Projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonësive të lejuara nga organi mbikëqyrës. Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: 960 ditë
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi bëhet konform kushteve të përgjithshme të kontratës. Menaxheri i Projektit do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA)

Parapagimi	26.1	Shuma e pagesës së paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale është: 140,000.00 € (Njëqindekatër dhjetë mijë Euro) sipas Ligjit Nr. 08/L-193 LIGJI NR. 08/L-193 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2023 Neni 13- Pagesat e paradhënies, pika 1. thotë: Organizatat buxhetore mund të paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në pesëmbëdhjetë përqind (15%) të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë e paradhënies mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetë mijë (10,000) Euro, e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. Për pagesën e paradhënies për projektet kapitale, kontrata duhet të përmbajë garancionin e performancës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë. ORARI I PAGESËS: Në dorëzimin e situacionit të parë, pagesa do ti ndalet në 30 % i shumës së parapaguar: 42,000.00 €; Në dorëzimin e situacionit të dytë, pagesa do ti ndalet në 30 % i shumës së parapaguar: 42,000.00 €; Në dorëzimin e situacionit të tretë, pagesa do ti ndalet në 40 % i shumës së parapaguar: 56,000.00 €; Për punët që duhen të kryhen para se të bëhen pagesat.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10 % të vlerës së kontratës Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga data e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi me kërkesë mund të zëvendësoj paratë të mbajtura me Polisë të sigurimit apo dokument bankar i lëshuar nga ndonjë Kompani e Sigurimeve apo Bankë e Licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës, prej 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës me afat validiteti prej: 36 muaj, nga data e lëshimit të certifikatës për pranimit të përkohshëm të punimeve.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është: 36 muaj . Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është: përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Numri i Prokurimit: 623.23.031.5-1-1 – Titulli: Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulturore në
Rahovec – Ritenderim

Aneksi - 6.1

AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE

Për: KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: [emri dhe adresa e operatorit ekonomik]
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE
KULTURORE NË RAHOVEC – Ritenderim

Numri i Prokurimit: 623-23-9402-5-1-1 & 623-23-031-5-1-1

Deklaratë e Operatorit Ekonomik për Afatin e Implementimit të projektit dhe Periudhën Garantuese

DERISA ne si tenderues kemi ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një ofertë në të cilën kriteri i dhënies është Tenderi Ekonomikisht Më i Favorshëm (TEMF), bazuar në nën kriteret për PERIUDHËN GARANTUESE dhe AFATIN E IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT, DEKLAROJMË se do të përmbushin kërkesat e Autoritetit Kontraktues për këtë projekt për një periudhat e përcaktuara si më poshtë:

I. AFATI I IMPLEMENTIMIT të këtij projekti është: 450 ditë, nga data e fillimit të punëve
Shëno numrin e diteve
e përcaktuar nga Menaxheri i Kontratës.

II. PERIUDHA GARANTUESE vlen 3 vite nga data e pranimit të përkohshëm të
projektit
Shëno numrin e viteve
nga Autoriteti Kontraktues, për projektin e cekur në këtë deklaratë.

KUJTIM THAQI
NPN EUROING SHPK

Emri i përfaqësuesit të OE



Nënshkrimi



PLANI DINAMIK

Projekti: NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEÇ – RITËNDËSË

Numri i Prokurimit: 623-23-9402-5-1-1

Numri i Bredshem: 623-23-031-5-1-1

Investitori: KOMUNA E RAHOVEÇIT

Nr.	PËRSHKRIMI I POZICIONEVE	Kujdi 1	Kujdi 2	Kujdi 3	Kujdi 4	Kujdi 5	Kujdi 6	Kujdi 7	Kujdi 8	Kujdi 9	Kujdi 10	Kujdi 11	Kujdi 12	Kujdi 13	Kujdi 14	Kujdi 15
1	Punët e përgatitore dhe demoluesve	1	2	3	4											
2	Punët e dheut dhe zvarrit															
3	Punët e b tërës															
4	Punët e armimit															
5	Punët e miz dritat															
6	Punët e hierozolit															
7	Punët e shtetit															
8	Punët e konstruktohet metalik															
9	Punët e adititëparis															
10	Punët e nivellimit, dyshemët															
11	Punët e keramikës dhe grurit															
12	Punët e suvaturit, platonet dhe mueshjet, punët e ngjyrosjes															
13	Punët e fasadës															
14	Punët e ndryshme dhe punët e jashtme															
15	HYDRICINSTALIMET															
16	INSTALIMET ELEKTRIKE															
17	INSTALIMET MAJINIERE															

PARAMASA PËR KRYERJEN E PUNËVE

NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC

Sqarim: Në të gjitha pozicionet parashihet furnizimi me material dhe kryerja e punëve. Tek punët demoluese, mbeturinat të dergohen në deponi ku e cakton komuna, kurse materialet që mund të duhen në të ardhmen, lokacionin e deponimit e cakton organi mbikëqyrës. Gjate gërmimit, materiali i pa-nevojshëm të dërgohet në deponi që e cakton komuna.

Verejtje:

Pas përfundimit të punëve PUNEKRYESË është i obliguar që të rregulloj, nivelizoj, pastroj dhe të kthej si në gjendje fillestare të gjitha demet e shkaktuara në parcelat dhe objektet përreth të cilët janë demtuar gjatë procesit të punimeve.

I. PUNËT NDËRTIMORE DHE ZEJTARE

I. PUNËT E PREGATITORE DHE DEMOLUESE

Poz. I	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1.1	Rrethimi i truallit për ndërtimin e objektit, lartësia e rrethojës duhet të jetë ~2.0m, rrethoja të jetë nga llamarinat e perforuar në kornizën e saj nga konstruksioni mbajtës nga druri apo metali.	m'	230.00	€ 20.00	€ 4,600.00
1.2	Montimi i portës hyrëse në kantier të ndërtimit, të jetë me lartësi 2 m dhe gjerësi 4-6m, dera të ketë hapje shiber (rreshqitëse). Kantieri i ndërtimit të ketë vetëm këtë portë hyrëse.	cope	1.00	€ 1,000.00	€ 1,000.00
1.3	Vendosja e tabelave dhe shenjave informuese për kantierin e ndërtimit si dhe për zonat e rrezikshme.	cope	12.00	€ 250.00	€ 3,000.00
1.4	Furnizimi dhe montimi i tualetëve për nevojat e kantierit të ndërtimit.	cope	1.00	€ 1,000.00	€ 1,000.00
1.5	Furnizimi dhe montimi i kontinjereve për nevojat e kantierit të ndërtimit.	cope	2.00	€ 2,000.00	€ 4,000.00
1.6	Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik.	cope	3.00	€ 500.00	€ 1,500.00
1.7	Furnizimi dhe vendosja e ndriqimit të kantierit të ndërtimit në perimetër, me reflektor adekuat çdo 25 m'	m'	120.00	€ 50.00	€ 6,000.00
1.8	Furnizimi dhe vendosja e kontinjerit afër portës hyrëse për personelin e sigurimit të kontinjerit të ndërtimit.	cope	1.00	€ 250.00	€ 250.00
1.9	Furnizimi dhe vendosja e shportave për mbeturinat (kontinjereve për mbeturina) të cilët do të zbrazen në vendet adekuate sahere që ka nevojë. Këto kontinjere të mbeturinave do të shërbejnë për nevojat e ndërtimit.	cope	2.00	€ 200.00	€ 400.00
1.10	Sjellja e makinerisë punuese dhe përgaditja e kompanisë për fillim të punëve.	cope	1.00	€ 4,000.00	€ 4,000.00



	PUNET DEMOLUESE: Gjate demolimit te objektit, te meren masat e sigurise, te kihet kujdes qe te mos lendohet ndonje punetor apo pale tjetër, te mos demtohet ndonje objekt afer i cili nuk eshte i parapare te demolohet, te mos demtohen makineri e automjete. Gjate demolimit te behet vazhdimisht ujitja e rrenojave qe te mos shkatohet shume pluhur. Materiali qe transportohet jasht te transportohet sigurt, te deponohet ne vende legjitime te caktuara nga komuna, gjate transportit te mos zhyten rruget e qytetit etj.				
1.11	Demolimi i mureve mbrojtese ekzistuese me lartesi mbi nivelin e tokes ~100 cm. Demolimi te behet me makineri adekuatë, dhe ne cmim te kalkulohet edhe demolimi i murit dhe themelit nen dhe. <i>Materiali e rrenuara apo te demoluara te transportohen jasht kantierit te ndertimit, te hudhen ne deponi mbeturinash, ne nje lokacion ku e cakton komuna, nese duhet te paguhet per hudhje te materialit te rrenuar, kjo ngarkes financiare bie mbi OE.</i>	m'	97.00	€ 50.00	€ 4,850.00
1.12	Pastrimi i complete hapësirës ku do te ndertohet objekti. Te parashihet pastrimi nga drunjet, shkurret, mbeturina te ndryshme etj, demolimi i trotuareve, stazave dhe te gjitha pozicioneve tjera sipërfaqeve tjera brenda lokacionit te cilat jane e punuara me materiale te forta. <i>Materiali e rrenuara apo te demoluara te transportohen jasht kantierit te ndertimit, te hudhen ne deponi mbeturinash, ne nje lokacion ku e cakton komuna, nese duhet te paguhet per hudhje te materialit te rrenuar, kjo ngarkes financiare bie mbi OE.</i>	m2	2500.00	€ 15.00	€ 37,500.00
1.13	Pozicionimi gjeodezik dhe shënjëzimi i objektit për ndërtim.	m2	2500.00	€ 2.00	€ 5,000.00
Totali 1					€ 73,100.00
2. PUNËT E DHEUT					
Poz.2	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
2.1	Gërmimi i shtresës së humusit me trashësi 30cm, duke llogaritur zgjerimin prej 1.0 m' rreth perimetri te objektit dhe largimi i dheut deri ne deponi.	m³	579.00	€ 10.00	€ 5,790.00
2.2	Gërmimi i dheut te kategorise 3 dhe 4 per hapjen e themeleve te objektit sipas projektit dhe transportimi i dheut deri ne deponi.	m³	8299.00	€ 8.00	€ 66,392.00
Totali 2					€ 72,182.00
3. PUNËT E ZHAVORIT					
Poz.3	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma

Investitori:
Komuna Rahovec



3.1	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses së zhavorit me fraksion 128, për mbushjen e bazës së themeleve. Moduli i ngjeshjes 40MPa.	m ³	460.50	€ 20.00	€ 9,210.00
3.2	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtresës së zhavorit sipas fraksioneve të parapara me projekt 0-63mm nën themele shiritore dhe nën pllaken e nivelit +0.00. Moduli i ngjeshjes 50MPa.	m ³	537.25	€ 20.00	€ 10,745.00
3.3	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtresës së zhavorit sipas fraksioneve të parapara me projekt 0-31.5mm në tabanin e themeleve dhe nën pllaken e dyshemese. Moduli i ngjeshjes 40MPa.	m ³	230.25	€ 20.00	€ 4,605.00
3.4	Furnizimi me materiale dhe vendosja e zhavorrit të drenazhes 31.5-63mm, në perimetër të mureve të jashtme për punimin e drenazhes.	m ³	465.50	€ 15.00	€ 6,982.50
Totali 3					€ 31,542.50

4. PUNËT E BETONIT

Poz.4	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
4.1	Furnizimi me material si dhe betonimi i tere sipërfaqes së objektit me beton C-16/20 të behet rrafshim i mire, betonimi me trashësi ~10 cm.	m ³	153.50	€ 100.00	€ 15,350.00
4.2	Furnizimi me material si dhe betonimi i themelit-pllake sipas projektit me beton C-30/37.	m ³	1280.00	€ 110.00	€ 140,800.00
4.3	Furnizimi me material si dhe betonimi i shtyllave dhe mureve të betonit (elementet vertikale) të të gjitha niveleve, të punohen sipas projektit, me beton C-30/37.	m ³	780.00	€ 110.00	€ 85,800.00
4.4	Furnizimi me material si dhe betonimi me beton kualitativ C-30/37, të pllakave dhe trajeve të të gjitha niveleve, me dimensione sipas projektit.	m ³	1550.00	€ 110.00	€ 170,500.00
4.5	Furnizimi me material si dhe betonimi me beton kualitativ C-30/37, të pllakes së lehtësuar mbi konstruksionin e auditoriumit, me dimensione sipas projektit.	m ³	40.00	€ 110.00	€ 4,400.00
4.6	Furnizimi me material si dhe betonimi i rampave, shkallëve hyrese, pllatoeve, me beton C-30/37. Të punohen sipas projektit. Në këtë pozicion të parashihet edhe armimi me rrjete Ø10mm 15/15cm.	m ³	45.00	€ 110.00	€ 4,950.00
Totali 4					€ 421,800.00

5. PUNËT E ARMATURËS DHE KONSTRUKSIONIT METALIK

Poz.5	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
-------	-------------------------	--------	-------	-------	-------



5.1	Furnizimi me material, prerja dhe lakimi i armaturave sipas detajeve te armimit si dhe armaturave rrjete te parapara me projekt. Çeliku për armaturë do të aplikohet në përputhje të plotë me normat ENV 10080 si dhe të posedon me karakteristikat që vijnë: Vlera karakteristike e kufirit të rrjedhjes (yield strength characteristic value) $f_{yk}=500$ N/mm² Madhësitë e diametrit të përputhen me vlerat nominale sipas ENV 10080 Furnizimi, prerja, lakimi dhe montimi i shufrave të armaturave duhet të bëhet sipas formave të paraqitura në detalet teknike si dhe të verifikohen në vendpunishte. Klasa e duktilitetit (ductility class) B-e lartë (high ductility) B 500 B.	kg	445000.00	€ 1.16	€ 516,200.00
5.2	Furnizimi me material si dhe montimi i konstruksionit te çelikut (profilet e çertifikuara) tek salla e koncerteve, te punohet sipas projektit, te behet edhe ngjyrosja adekuat. Çeliku duhet te montohet ne perputhje me normat dhe standardet e parapara per keto punime. Kualiteti i celikut dhe saldimit behet ne perputhje me ISO standarde. Atestet e materialit dhe punes jane te domosdoshme. Konstruksioni i celikut lyhet me ngjyre antikoorduese minium dhe me ngjyre per hekur. Sipas projektit te statikes dhe tabelave te materialit me poz. te vecuara - Anker pllakat - Pllakat lidhese - Konstruksioni primar - Brinaket - Shtangimet - Pllakat lidhese per profilat dhe saldimit, etj Llogaria ne kg .	kg	22500.00	€ 2.50	€ 56,250.00
5.3	Furnizimi transporti dhe montimi i llamarines per pllaken e lehtesuar te kulmit mbi sallën e koncerteve. Lllamarina duhet te jete e galvanizuar, me trashesi $t=0.8$ mm, me brinje 40/80 ne distance aksiale 200 mm. Ne cmim te kalkulohen edhe te gjitha elementet e nevojshme per fiksimin e llamarines ne brinake.	m ²	385.00	€ 12.00	€ 4,620.00



Investitori:
Komuna Rahovec

DEA

5.4	Furnizimi transporti dhe montimi i shkalleve emergjente me dimensione (bxl==150x780) m dhe (bxl==120x380) m . Konstrukcioni i shkalleve te punchet nga metali, shkelesja nga llamarinia jo e rreshqiteshme me trashesi t=6 mm. Ne cmim te kalkulohet edhe punimi i gardhit te shkalleve nga metali, ngjyrosja e metalit me ngjyre antikoorduese minium dhe me ngjyre per hekur, si dhe te gjitha elementet e nevojshme per montimin e shkalleve si: ankerat, vida, pllaka lidhese etj. Llogaria ne Kg.	Kg	4350.00	€	3.00	€	13,050.00
Totali 5							€ 590,120.00

6. PUNËT E HIDROIZOLIMIT

Poz.6	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
	KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PUNËT E HIDROIZOLIMIT Punët e hidroizolimit në përgjithësi duhet të kryhen sipas projektit, Normave dhe Standardeve në fuqi. -Materjali që përdoret për punët e izolimit duhet të jetë i atestuar. -Baza në të cilën vendoset izolimi më parë duhet të jetë i terur, dhe i pastruar nga pluhuri dhe yndyra. -Materjali i paraparë për izolim mund të zëvendsohet me ndonjë material tjetër në rast se ekziston ndonjë material me cilësi më të mira.				
6.1	Furnizimi me material dhe hidroizolimi horizontal i themel-pllakes ne Bodrum mbi shtresen e betonit te varfer. Betoni i varfer duhet te jete i thate dhe i paster. Sistemi i shtresave te hidroizolimit duhet te jete: - Gjeotekstil - PVC folie, prodhuesi nga vendet e EU, me trashesi 1.5 mm e salduar ne tegele me ajer te nxehte me te gjitha materialet percjellese duke perfshire shiritin metalik ne perimenter, shtangimet, silikonin dhe kendoret me material PVC. - Gjeotekstil Ne cmim te kalkulohet edhe izolimi i vrimeve/departimeve te instalimeve nga toka per ne pllaken e themelit. <i>Hidroizolimi te punohet me kujdes sipas rekomandimeve te dhena nga prodhuesi, dhe pas perfundimit te behet testimi.</i>	m ²	1730.00	€ 5.00	€ 8,650.00



DEA Division of
Enforcement
Activity

7. PUNËT E MURATIMIT

7.3	Furnizimi me material si dhe punimi i mureve nga pllakat e gipskartoni (2x12.5 mm) ne secilen ane. Nga te dy anet duhet te jene nje pllake gipsi akustike dhe nje tjetër pllake e thjeshte (shih detalin ne arkitekture). Kontruksioni i mureve te jete metalik CW 100/UW 100. Fugat mes pllakave te gipsit trajtohen me mbushje sipas instruksioneve te prodhuesit, dhe te gjitha detajet duhet te punohen sipas rekomandimeve nga prodhuesi. Ne cmim te kalkulohet edhe izolimi termik/akustik - Lesh Guri 60kg/m3 me trashesi $\tau=100$ mm, patinimi dhe rrafshimi i mureve me glet si parapregaditje per ngjyrosje.	m2	1605.00	€ 30.00	€ 48,150.00
7.4	Furnizimi me material si dhe punimi i mveshjeve anesore nga pllakat e gipskartoni (2x12.5 mm) mveshja e instalimeve, kufizimet e nevojshme ne pilafone, dhe elementet tjera te nevojshme, me dy shtresa te knaufit. Kontruksioni i mureve te jete metalik CW 100/UW 100. Fugat mes pllakave te gipsit trajtohen me mbushje sipas instruksioneve te prodhuesit, dhe te gjitha detajet duhet te punohen sipas rekomandimeve nga prodhuesi. Ne cmim te kalkulohet edhe izolimi termik/akustik - Lesh Guri 60kg/m3 me trashesi $\tau=100$ mm, patinimi dhe rrafshimi i mureve me glet si parapregaditje per ngjyrosje.	m2	85.00	€ 25.00	€ 2,125.00

Totali 7 € 144,925.00


8. PUNËT E NIVELIZIMIT

Poz.8	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
8.1	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit me trashësi 5-7cm (~6 cm) mbi pllakat e polistirenit te ekspanduar EPS në të gjitha kthinat e brendshme te objektit, duke përfshirë shtresën ndarëse nga folia e PVC-së dhe shiritin nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Estrihu te armohe me fibra plastike te cilat duhet te vendosen gjate perzierjes, sasia e fibrave sipas rekomandimeve te prodhuesit.	m ²	4050.00	€ 7.00	€ 28,350.00
8.2	Furnizimi me material dhe vendosja e pllakave te polistirenit te ekspanduar EPS ne te gjitha kthinat e mbrendshme te objektit me trashesi $\tau=2.5+2.5$ cm. Keto pllaka vendosen per izolim termik dhe akustik sipas detaleve dhe udhezimeve te prodhuesit.	m ²	4050.00	€ 5.00	€ 20,250.00

Totali 8 € 48,600.00

9. PUNËT E DYSHEMESË

Poz.9	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
9.1	Furnizimi me material si dhe montimi: Dyshemeja ne kthinat e parapara ne projekt do te punohet nga Vinyl Acoustic si shtrese finale. Pas shtresave te Pilakes se betonit, shtreses hidroizoluese, termolizolimi, nivelizimi, vjen si shtrese perfundimtare shtresa e Vinyl Acoustic, me pershkrime si me poshte: Trashesia 8.3 mm., pesha totale 6.035 kg/m², Gjeresia 2 m., Gjatesia 17.2/27.5m, aftesia thithese 33%, deformimi vertikal 1.2mm.-1.3mm., levizja vertikale e topit 100% - 99% - 98%, reagimi ndaj zjarrit Cfl s1, rezistenca e qendrueshmerise ≤1g, rezistenca nga gjurmët 0.29 mm/-0.39mm≤0.50mm., rezistenca nga ngarkesa 0.10mm/-0.30mm, reflektimi i zerit 20dB, zhurmat e brendshme Klasa A ≤ 65 dB, Rezistenca termike 0.12 m² K/W, Ngjyra te perzgjedhet nga organi mbikqyres. Ne cmim te kalkulohet edhe montimi i llojsneve nga materiali i njejt (te rekomanduara nga prodhuesi i dyshemese) ne perimetre te kthinave	m ²	1415.00	€ 25.00	€ 35,375.00
9.2	Furnizimi dhe vendosja e parketit te kualitetit te larte pa nyje ne kthinat e parapara me projekt. Panele me madhesi 2450x188 mm, 2450x290 mm, 2450x590 mm (apo tjeter te perzgjedhur nga organi mbikqyres), me trashesi te parketit t=14 mm të trasha ngjitur, në një sipërfaqe të përgatitur, te pastruar dhe të thatë. Ngjitja e parketit me ngjites adekuat te rekomanduar dhe garantuar nga prodhuesi. Ne cmim te kalkulohen edhe llajset perimetrike nga druri. Perzgjedhja e tekstures se parketit te behet sipas rekomandimeve te organit mbikqyres	m ²	305.00	€ 35.00	€ 10,675.00
9.3	Furnizimi me material si dhe montimi: Dyshemeja epokside per sallën e koncerteve dhe kthinat tjera sipas projektit. Gërryerja dhe pastrimi (me thithese profesionale) i nenshtreses (estrih). Furnizimi dhe punimi i dyshemese epokside ne trashesi totale se paku 2,0 mm, me materiale te certifikuar per ambiente te mbrendshme (ekologjike). Shtresa baze epokside, punimi i shtreses vetenivelizuese me epoksid duke i hedhur siper grimcat dekoruese (chipsa). Shiriti anesor te punohet nga profili metalik ne forme harkore (me rreze ca. 20cm) dhe lartesi 70mm, i lyer me material te njejte sikur dyshemeja. Lloji i ngjyres dhe tekstures se epoksidit te zgjedhet nga organi mbikqyres.	m ²	635.00	€ 25.00	€ 15,875.00



DEA Division of
Engineering
Architecture

10.1	Furnizimi me material dhe mvëshja e mureve të nyjeve sanitare dhe kthinave tjera sipas projektit me pllaka të paglazura qeramike me dimensione, me ngjyrë dhe teksturë të përcaktuar nga organi mbikqyrës. Plakat duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut.	m ²	1405.00	€ 20.00	€ 28,100.00
10.2	Furnizimi me material dhe mvëshja e shkallëve të brendshme me pllaka graniti të poliruar: - shkallët e galerisë në hollin qendror: Shkelëset - 30.0 x 200 cm dhe trashësi 2cm Balloret - (16.84-17.39) x 200 cm dhe trashësi 1cm Cope - 84 cope (95 m2) - shkallët e hollit të sallës së koncerteve: Shkelëset - 30.0 x 440 cm dhe trashësi 2cm Balloret - 16.0 x 440 cm dhe trashësi 1cm Cope - 17 cope (37 m2) - shkallët të shkollës së muzikës: Shkelëset - 30.0 x 120 cm dhe trashësi 2cm Balloret - (16.84-17.39) x 120 cm dhe trashësi 1cm Cope - 46 cope (38 m2) - shkallët të berthamës në 6 kate: Shkelëset - 30.0 x 160 cm dhe trashësi 2cm Balloret - (16.84-17.39) x 160 cm dhe trashësi 1cm Cope - 123 cope (172 m2) Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm. Basamakët që zbresin nga pushimoret të zgjaten në tërë gjatësinë e pushimoreve në vijë të drejtë. Në çmim të përfshihet edhe punimi i cokllës së shkallëzuar nga pllakat me lartësi 10 cm dhe trashësi 1 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave	m ²	345.00	€ 85.00	€ 29,325.00
10.3	Furnizimi me material dhe mvëshja e kornizës rreth dymve të ashensorit me pllaka graniti të poliruar me trashësi 2 cm. Gjerësia e kornizës 25 cm. Thellësia e mvëshjes min.25 cm. Ngjitja të bëhet me ngjitës adekuat për pllaka graniti ndërsa fuga punuese në kontakt me dyert e ashensorit të mbushet me silikon sanitar. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	32.00	€ 85.00	€ 2,720.00



10.4	Furnizimi me material dhe mveshja e parapetit te mbrendeshem dhe te jashtem te dritareve me pllaka graniti të poliruar me trashësi 2 cm dhe gjerësi min 16cm. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min. 2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m'	390.00	€ 20.00	€ 7,800.00
10.5	Furnizimi me material dhe mveshja platove, rampave dhe shkalleve te jashtme te objektit (hyrjet ne objekt) me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë/të flakëruar, trashësi 2 cm. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm. Në çmim të përfshihet edhe punimi i cokllës së shkallëzuar nga pllakat me lartësi 10 cm dhe trashësi 2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	135.00	€ 85.00	€ 11,475.00

Totali 10 € 79,420.00

II. PUNËT E PLLAFONIT DHE MVESHJEVE

Poz. II	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
11.1	Furnizimi dhe montimi i tavanit te varur i tipit D112 GKB A13 EN520 TE KTHINAT E MBRENDSHME (shih bazat e ndertimit ne pjesen grafike). Varja behet ne distance prej 38cm nga pllaka, kane trashesi t=1.25cm dhe me gjerësi 125cm. Profilet mbajtes kryesor te plafonit varen me varesë direkte ose ngjashem ne hap d=75cm. Profilet mbajtese kryesor vendosen ne distance 75-85cm, ndersa profilet montuese vendosen ne drejtimin e kundert cdo 40cm. Fugimi te behet me fugenfuller leicht, vidhosja me vida TN 25	m ²	1478.00	€ 15.00	€ 22,170.00
11.2	Furnizimi dhe montimi i tavanit te varur i tipit - D127 Cleaneo Acoustic TE SALLA E KONCERTEVE (shih bazat e ndertimit ne pjesen grafike).Varja behet ne distance prej 25cm me pllaka, kane trashesi t=1.25cm dhe me gjerësi 125cm. Profilet mbajtes kryesor te plafonit varen me varesë direkte ose ngjashem ne hap d=75cm. Profilet mbajtese kryesor vendosen ne distance 75-85cm, ndersa profilet montuese vendosen ne drejtimin e kundert cdo 40cm. Fugimi te behet me fugenfuller leicht,vidhosja me vida TN 25	m ²	465.00	€ 50.00	€ 23,250.00



11.3	Furnizimi dhe montimi i tavanit të varur kundër lageshtësie TE KTHINAT SANITARE (shih bazat e ndërtimit në pjesën grafike). Varja bëhet në distancë prej 38cm nga pllaka, kanë trashësi $t=1.25\text{cm}$ dhe me gjatësi 125cm. Profilët mbajtes kryesor të plafonit varen me varesë direkte ose ngjashëm në hap $d=75\text{cm}$. Profilët mbajtes kryesor vendosen në distancë 75-85cm, ndërsa profilët montuese vendosen në drejtimin e kundërt cdo 40cm. Fugimi të bëhet me fugenfuller leicht, vidhosja me vida TN 25	m^2	283.00	€ 15.00	€ 4,245.00
11.4	Furnizimi me material dhe mveshja e sipërfaqes së brendshme e mureve perimetrike anësore të Shkollës e Muzikës (Klasa e Baletit dhe Studio për kërcim) me panele akustike nga druri - PERFO AKUSTIK, sipas projektit. Para montimit të pllakave të gipsit duhet të punohet konstruksioni mbajtes nga profilët montuese të aluminit të cilat duhet të vendosen në distancë të caktuar nga njëra tjetra sipas udhëzimeve të prodhuesit. Në cënim të kalkulohen edhe të gjithë aksesoret e nevojshëm për montimin e konstruksionit dhe pllakave akustike.	m^2	275.00	€ 50.00	€ 13,750.00
